

NJOFTIM
Nr. 212/2, datë 13.1.2023

**MBI FILLIMIN E BISEDIMEVE PËR LIDHJEN E KONTRATËS KOLEKTIVE TË
PUNËS NË FUSHËN E MËSUESISË**

Në zbatim të kreut XV të Kodit të Punës dhe kërkesës së disa organizatave përfaqësuese sindikale, Ministria e Arsimit dhe Sportit njofton fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Të gjitha organizatat përfaqësuese sindikale në fushën e mësuesisë ftohen të shprehin interesin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm, brenda datës 31 janar 2023, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni duhet të përmbajë dokumentet e parashikuara në pikën 3, të nenit 163, të Kodit të Punës, si më poshtë:

- Kërkesë për fillimin e bisedimeve;
- Vendimin e gjykatës dhe statutin e organizatës;
- Dokumentacionin me treguesit e nevojshëm për përfaqësueshmërinë e anëtarësisë sindikale.

Ky njoftim të publikohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar. Po ashtu, ky njoftim botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi